

Zhvillohet mbledhja e pare e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, me objekt projekt buxhetin e KLSH-së për vitin 2025 dhe raportin e auditimit të performancës “Kujdesi ndaj të moshuarve”

Në datën 12.11.2024, u zhvillua mbledhja e parë e Nënkomisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik. Shqyrtimi i projektbuxhetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2025, si dhe prezantimi i raportit të auditimit të performancës “Kujdesi ndaj të moshuarve” ishin dy çështjet e rendit të ditës.

Nën drejtimin e kryetares së Komisionit, znj. Emilia Koliqi, u zhvillua dëgjesa për projektbuxhetin me përfaqësuesit e KLSH-së. Në këtë mbledhje morrën pjesë znj. Valbona Gaxha, Sekretare e Përgjithshme, znj. Brunilda Zeneli, Drejtoreshë e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar dhe znj. Alketa Kalleshi, Nëpunëse Zbatuese.



Znj. Valbona Gaxha, sqaroi se në hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme 2025-2027, prioritet mbetet shtimi i punonjësve për shkak të kërkesave në rritje për auditime nga grupet e interesit, investimet IT në funksion të rritjes së sigurisë kibernetike, si dhe miratimi i fondit të përlogaritur për krentimin e 100 vjetorit të krijimit të instirtucionit.

Kryetarja e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, znj.Emilia Koliqi, informoi se raporti me kërkesat e KLSH-së do t’i përcillet për shqyrtim Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, pas rakordimeve të kërkesave me Ministrinë e Financave.



Pas dëgjesës për projekt buxhetin, mbledhja vijoi me prezantimin e raportit të auditimit të performancës “Kujdesi ndaj të moshuarve”. Znj. Arminda Bushi, audituese në KLSH, bëri

një përmbledhje të gjetjeve kryesore të auditimit, duke evidentuar numrin e pamjaftueshëm të punonjësve që ofrojnë shërbime në qendrat rezidenciale, mungesën e infrastrukturës dhe aksesit për të kryer shërbimin sipas standardeve për të moshuarit, etj.